

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.

Nr. 464/6 Prot

Korçë, më 24.3.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Blerje kompjuterash dhe pajisjesh kompjuterike"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 30200000- 1 Pajisje kompjuterike dhe furnizime

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,011,922 (tre milionë e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4, me vlerë 60,238.44 (gjashtëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e tetë presje dyzet e katër) lekë (2% të vlerës së përlllogaritur të kontratës).
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Bendis Samarxhi

Paoljo Zegullaj

Ornela Hysenlli

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit të kualifikimit të përcaktuara në D.S.T.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, të ndryshuar, nenit 40, pika 5, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c e 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore argumentohet si më poshtë: Sipas ligjit nr. 29, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bendis Samarxhi

Paoljo Zegullaj

Ornela Hysenlli

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për furnizimet e mëparshme të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

- b) për furnizimet e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi/distributori i autorizuar për tregtimin e artikujve TIK objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website. Kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm që na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standarde të përshtatshme cilësie. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për aftësitë teknike dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe pikën 6 dhe 8, të nenit 40, të VKM- së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit (të përkthyer dhe të noterizuar) vetëm për produktet specifike Kompjuter desktop 1. Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme produktet që ofertohen sipas ofertës teknike të OE Ofertues dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produkteve që janë përmendur, me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produktet e ofruara plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Katalogu është një dokument i rëndësishëm që na njeh me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standarde të përshtatshme cilësie. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për aftësitë teknike dhe i shërben

autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe pikën 6 gërma b) të nenit 40, të VKM- së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të kryejë, të gjitha verifikimet që i konsideron të nevojshme mbi vlefshmërinë e dokumenteve të kërkuara.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

II. Specifikimet teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024 **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Pershkrimi	Njësia	Sasia	Afati
1	Kompjutera desktop 1 sipas akshit	Cope	22	20 ditë
2	SSD 256 gb	Cope	10	20 ditë
3	NVME 256 gb	Cope	5	20 ditë
4	Monitor 27 inch	Cope	5	20 ditë
5	Kabull korrenti	Cope	10	20 ditë
6	Kabull HDMI	Cope	5	20 ditë
7	Kabull VGA	Cope	5	20 ditë
8	Tastierë usb	Cope	5	20 ditë
9	Mouse usb	Cope	5	20 ditë
10	Web camera	Cope	1	20 ditë
11	Mikrofon	Cope	5	20 ditë
12	Printer Termik 80 mm x 60 mm	Cope	3	20 ditë

**AKSHI Standardet Teknike për pajisjet elektronike për përdorim zyre
KOMPJUTERA Desktop 1**

1. DESKTOP 1 sipas AKSHI

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	8500 Pikë
“RAM”:	8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:	500 GB SSD
“Disk Subsystem Controller”:	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Integrated graphic Card, min. 1 GB
“Media Device”:	DVD+/-RW
“Slots”:	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA
Rrjeti “Networking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card

“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”:	(≥ 27)
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti i Kontratit “Contrast Ratio Static”:	1000:1
“Display Port”:	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

2. SSD dhe SSD NVME

Duke marrë parasysh që sistemet e reja të operimit si Windows 10 dhe Windows 11 kërkojnë parametra më të avancuar për funksionim optimal, është e nevojshme të përmirësojmë disa prej kompjuterave aktualë që përdorin HDD me shpejtësi mesatare rreth 100 MB/s, duke i zëvendësuar me SSD që arrijnë deri në 500 MB/s. Për këtë arsye, parashikohet blerja e 10 SSD për të përmbushur nevojat e kompanisë. Gjithashtu, disa prej kompjuterave të rinj në përdorim në UKRK janë të pajisur me disqe SSD NVMe, të cilët arrijnë shpejtësi deri në 3500 MB/s; për të ruajtur performancën dhe vazhdimësinë e punës, rekomandohet zëvendësimi i tyre me modele të njëjta, duke parashikuar blerjen e 5 SSD NVMe shtesë.

Specifikat teknike kryesore të SSD		Specifikat teknike kryesore të NVME	
Kapaciteti (Storage Capacity)	240 GB / 256 GB	Kapaciteti (Storage Capacity)	240 GB / 256 GB
Forma fizike (Form Factor)	2.5 inch	Forma fizike (Form Factor)	SSD i vogël direkt në motherboard
Read Speed:	500–7500 MB/s	Read Speed:	3500–7500 MB/s

Write Speed:	450–7000 MB/s	Write Speed:	3000–7000 MB/s
---------------------	---------------	---------------------	----------------

3. Monitor 27 inch

Duke marrë parasysh punën dhe volumin e dokumentave që punonjësit e UKRK kanë, lind nevoja për të updetuar monitorët në monitorë më të mëdhenj. Përveçse lehtëson punën e punonjesve, monitorët aktuale janë shumë të vjetër dhe kanë filluar të humbin kualitetin e tyre dhe ndriçimin.

Specifikat teknike kryesore	
Madhësia	27 inch
Rezolucion	FHD 1920 x 1080
Refresh Rate	60 Hz
Portat e lidhjes	1x HDMI, 1x DisplayPort, 1x VGA

4. Kabuj kompjuterash

Kabllo e rrymës janë elementë thelbësorë për funksionimin e kompjuterëve, pasi pa to pajisjet nuk mund të furnizohen me energji elektrike. Në rast dëmtimi ose konsumimi të këtyre kabllove, ato duhet të zëvendësohen menjëherë për të mos ndërprerë procesin e punës. Po ashtu, kabllo e lidhjes me monitorë, si VGA dhe HDMI, janë të domosdoshme për shfaqjen e imazhit dhe për funksionimin normal të pajisjeve; për këtë arsye, duhet të jenë gjithmonë në gjendje të mirë dhe të zëvendësohen në rast defekti për të siguruar vazhdimësinë e punës pa ndërprerje.

5. Tastiere dhe mouse

Tastiera dhe mouse-i janë pajisje hyrëse që përdoren vazhdimisht gjatë punës së përditshme dhe, për pasojë, kanë një shkallë të lartë konsumimi. Duke marrë parasysh volumin e madh të dokumenteve dhe ngarkesën e punës në UKRK, është e nevojshme që në magazinë të ketë gjithmonë rezerva të këtyre aksesoreve, në mënyrë që të mundësohet zëvendësimi i tyre i menjëhershëm në rast prishjeje, pa ndikuar në vazhdimësinë dhe efikasitetin e punës.

TASTIERË USB

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Lloji i ndëfaqes	USB
Numri i tasteve	104
Madhësia	470x150x26mm
Gjatësia e kabllit	1500 mm
Sistemi i operimit	Windows 7 e sipër dhe Mac OS 10.3 e sipër

6. MOUSE USB

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Lloji i ndëfages	USB
DPI	1600
Butonat	4 butona 1 rrotë lëvizëse
Gjatësia e kabllit	1500 mm
Sistemi i operimit	Windows 7 e sipër dhe Mac OS 10.3 e sipër

7. KAMERA - Web-i Për Kompjutera sipas AKSHI

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
"Model":	Webcam, Min. Full HD 1080P
Autofocus:	Po
Mikrofon i integruar:	Jo i detyrueshëm
Ndërfaqja me kompjuterin:	USB tipi A
Field of view:	Min. 78°
Mënyra e instalimit:	Automatikisht (pa pasur nevojë për drivera)
Sistemi i Operimit të suportuar:	Windows 10 64-bit Prof. dhe më i mirë, Mac
Mënyra e vendosjes:	Mbi ekran
Gjatësia e kabllit:	Min. 1.5 m
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	6 Muaj

8. Mikrofon

Tipi i mikrofonit	Speakerphone
Kapja e zërit	Omnidirectional 360°
Distanca e kapjes së zërit	≥5 metra
Lidhja	USB Plug & Play
Kompatibilitet software	Microsoft Teams, Zoom, Google Meet
Garancia	2 vite

9. Printer Termik

Teknologjia e printimit:	Direct Thermal
Gjerësia e letres:	80 mm x 60 mm
Rezolucioni i printimit:	minimumi 203 dpi
Shpejtësia e printimit:	minimumi 90–120 mm/s
Lidhja me pajisjen:	USB për komunikim kompjuter
Sensorë	Sensor për fundin e letres Sensor për letër afër fundit Sensor për kapakun e hapur
Performanca dhe jetëgjatësia	Jetëgjatësia e kokës së printimit: deri në 100 km printim Prerës automatik (Auto-cutter): deri në 1,000,000 prerje

Afati i lëvrimit: 20 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës

Vendi i dorëzimit: Malli do të dorëzohet në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë konform dokumentacionit ligjor dhe teknik të kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe të marrë përsipër në ofertë nga ofertuesi.

Argumentim:

Specifikimet teknike, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me pajisjet kompjuterike, Specifikimet teknike të Desktop 1 dhe të web kamerës janë hartuar duke u bazuar në Specifikime Teknike “Pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për përdorim zyre” të Agjencisë Kombëtare së Shoqërisë së Informacionit (të vlefshme për periudhën 1 Janar 2025-31 Dhjetor 2025).

Ndryshimi i përmasave të monitorëve nga madhësia $\geq 21''$ në $\geq 27''$ është i domosdoshëm për të përmirësuar komoditetin dhe efikasitetin gjatë punës. Monitorët me ekran më të madh ofrojnë një hapësirë më të gjerë vizuale, e cila është veçanërisht e nevojshme për punën me dokumente të shumta, tabela Excel me shumë “sheet”-e dhe kolona të gjera. Kjo mundëson shikim më të qartë dhe organizim më të lehtë të informacionit, duke reduktuar lodhjen e syve dhe gabimet gjatë punës, si dhe duke ndikuar pozitivisht në rritjen e produktivitetit të punonjësve.

Paoljo Zegullaj (Specialist IT)